

Data 13.08.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Inspektim periodik i ashensorëve të QSUNT. Marrëveshje Kuadër për 12 muaj”.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Shërbim për inspektim teknik të veprave inxhinierike 71631400-4

VLERA E FONDIT LIMIT:

1.333.333,33 (një milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e tre pikë tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”** ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 10:

Argumentimi: Ky kriter u vendos me mbështetje në nenin 76 të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, dhe nenin 26 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, në të cilën është përcaktuar se: *“1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla.”.*

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3:

Argumentimi: Ky kriter u vendos sipas nenit 83 Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, në të cilën është parashikuar se:

Pika 1 Neni 83: Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël.

Pika 2 Neni 83: Autoriteti ose enti kontraktor duhet të specifikojë në dokumentet e tenderit:

- a) vlerën e kërkuar të sigurimit të ofertës, e cila duhet të jetë 2% e vlerës së përlllogaritur të kontratës;
- b) çdo kërkesë për natyrën dhe formën e sigurimit të ofertës, si dhe ne nenin 30 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- a) Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me Çertifikatën e Akreditimit për Inspektimin lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit, në përputhje me standartin **SH EN ISO / IEC 17020:2012**: “kritere të përgjithshme – funksionimin e tipeve të ndryshme të organizmave që kryejnë inspektim” e cila duhet të përkojë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen, **ose ekuivalent**.
- b) Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Çertifikate ISO 9001:2015 Kërkesat e sistemit të menaxhimit të cilësisë ose ekuivalent**, **Certifikatë ISO/IEC 45001: 2018 Sistemi i menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ose ekuivalent**, objekti i së cilës të ketë lidhje me objektin e prokurimit.
- c) Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **”Akt –miratimin, Organ i Miratuar i vlerësimit të konformitetit lëshuar nga Ministria e Përgjegjëse, (Tipi OMVK) për fushën e veprimtarisë: Inspektim periodik dhe vlerësimi i konformitetit të ashensorëve**.

Shënim: të gjitha certifikatat e mësipërme të jetë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizimi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë dhe të vlefshme gjatë periudhës së prokurimit.

Argumentimi: Këto kritere janë percaktuar në piken b) dhe c) është vendosur në përputhje me piken 1 të nenit 79 të Ligjit nr.162/2020 “Per Prokurimin Publik”, në të cilën gjejmë të percaktuar se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikatat lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

Ky kriter gjen mbështetje në piken 1 të nenit 44 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku percaktohet se: 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.

Gjithashtu ky kriter gjen mbështetje dhe në rekomandimin e APP dhe Drejtorisë së përgjithshme të Akreditimit nr. 3330 prot, date 20.03.2018 dhe nr. 145 prot, date 16.03.2018 “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”.

ISO 9001:2015 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë kur një entitet (shoqëri tregtare etj.): a) duhet të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar vazhdimisht produkte dhe shërbime që plotësojnë kërkesat e pacientit (në rastin e QSUNT) dhe të aplikueshme statutore dhe rregullatore, dhe b) synon të rrisë sadsfaksionin e pacientit (në rastin e QSUNT) nëpërmjet aplikimit efektiv të sistemit, duke përfshirë proceset për përmirësimin e sistemit dhe sigurimin e konformitetit me kërkesat e klientit dhe statutore dhe rregullatore në fuqi. ISO 45001:2018 specifikon kërkesat për një sistem të menaxhimit të cilësisë, ku një entitet duhet të demonstrojë aftësinë e tij për të ofruar pajisje mjekësore dhe shërbime të lidhura me to që plotësojnë vazhdimisht kërkesat rregullatore të klientit dhe ato të aplikueshme. Entitete të tilla mund të përfshihen në një ose më shumë faza të ciklit jetësor, duke përfshirë projektimin dhe zhvillimin, prodhimin, ruajtjen dhe shpërndarjen, instalimin ose servisimin e një pajisjeje mjekësore dhe projektimin dhe zhvillimin ose ofrimin e aktiviteteve të ndërlidhura (p.sh. mbështetjen teknike).

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

a) Vërtetim nga Dega e Tatimeve për xhiron vjetore të realizuar gjate 3 (tre) viteve te fundit financiare (2022, 2023 dhe 2024) ku vlera e tyre te jete **jo me e vogel se 40% e vlerës së fondit limit.**

Nëse operatorët ekonomikë, për lotin/lotet që konkurrojnë, arrijnë vlerën e xhiros minimale të kërkuar në këto DT, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar, kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur.

Argumentimi: Ky kriter, eshte vendosur ne perputhje me piken 3 te nenit 77 te Ligjit nr 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejme te percaktuar se: 3. *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar. Gjithashtu, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore që të tregojnë raportet ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës.*; ne piken 1 dhe piken 2/a te nenit 43 te VKM nr. 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ku percaktohet se: Pika 1. Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare. Pika2/a: 2. Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar;Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine ekonomike dhe financiare te OE ofertues, duke vertetuar nepermjet dokumenteve te kerkuara me poshte, se zoterojne kapacitet ekonomike dhe financiare per te permbushur kontraten sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Legjislatori në ne piken 1 dhe piken 2/a të nenit 43 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ka parashikuar marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohej në Procedurën e Hapur, ku përcaktohet; Pika 2/a: 2. *Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohej operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalohet: a) dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar*; Referuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure AK ka menduar se vendosja e një vlere minimale të xhiros jo më e vogël se **40 % e vlerës së fondit limit* për të cilat konkurron operatori, është një deshmi e mjaftueshme për të krijuar** bindjen tek Autoriteti Kontraktor se Operatorët Ekonomikë ofertues zoterojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 të VKM 285/2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar ku përcaktohet se: *Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*; si dhe nenit 13 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 ‘Për Tatimin Mbi të Ardhurat’ i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për Deklaratat individuale vjetore të të ardhurave; (Ligj nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, neni 13 pika 2. *Tatimpaguesit e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dorëzojnë deklaratën vjetore të të ardhurave pranë administratës tatimore qendrore, jo më vonë se data 30 prill e vitit që pason periudhën tatimore, për të cilën bëhet deklarimi.*).

2.3 Kapaciteti teknik:

a) Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë **jo më të vogël se 20 %** të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontrata/kontratat perkatese të shoqeruara me vërtetimin e realizimit me sukses të saj/te tyre, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, dhe / ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Shënim*: Për efekt të përlllogaritjes së vlerës së kërkuar sipas këtij kriteri, shuma e mësipërme do të aplikohet mbi vlerën e fondit limit të parashikuar në Seksionin: 2.10 Përshkrim i shkurtër i kontratës.

Argumentimi: Ky kriter u vendos në përputhje me piken 4 te nenit 77 te Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, "Per Prokurimin Publik", ne te cilin gjejmë te percaktuar se: 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës; si dhe me piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik", ne te cilin eshte e percaktuar se: [...]4. Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit. Në çdo rast, vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës. Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe piken 4 te nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik". Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë jo më të vogla se **20 %** e vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Autoriteti Kontraktor QSU "Nënë Tereza" Tiranë është institucion terciar Shëndetësor Publik Kombëtar në shërbim të shëndetit të popullatës, të cilës i siguron shërbim shëndetësor parandalues, diagnostikues dhe kurues sipas Kushtetutës së Shqipërisë dhe ligjeve të shëndetit publik. Vendosja e këtij kriteri behet me qellim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, per aftesine teknike te OE ofertues, nepermjet pervojave

te duhura, qe jane ne perpjesetim me natyren e objektit te prokurimit dhe qe ka aftesine e duhur per zbatimin e kontrates sic eshte parashikuar nga AK.

- b) Operatori Ekonomik duhet të lëshojë një Deklaratë me anë të së cilës **merr përsipër sigurimin teknik të stafit të tij** gjatë kohës së punës në ambientet e QSUNT, dhe kjo e fundit nuk mban asnjë përgjegjësi për aksidentet e ndodhura punonjësve të Operatorit Ekonomik në ambientet e saj.

Argumentimi: Ky kriter u vendos ne mbështetje te shkresës 1132/6 prot., datë 26.05.2025 Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt **“Inspektim periodik i ashensorëve të QSUNT. Marrëveshje Kuadër për 12 muaj”**, bazuar në urdhër të titullarit të përgjithshëm me Nr. 186 datë 05.05.2025”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 1132/17 prot., datë 01.08.2025 ‘Kërkesë për rihapje procedure’ të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse dhe u miratua nga anetaret e Njesise se Prokurimit qe kane specialitetin perkates ne lidhje me kriteret teknike.

- c) Të ketë një **menaxher/drejtues teknik** përgjegjës për menaxhimin e administrimit teknio-profesional të trupës inspektuese. Të vërtetuar nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe listëpagesës së muajit të fundit.

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar Urdhërin nr.53 datë 05.10.2017 ”Për miratimin e rregullores për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit”, Kreu VII, pika c).

- d) Të ketë të paktën një **grup inspektimi**, të përbërë jo më pak nga 2 specialist inspektorë. të vërtetuar nëpërmjet kontratës individuale të punës dhe listëpagesës së muajit të fundit.

Argumentimi: Ky kriter i përcaktuar Urdhërin nr.53 datë 05.10.2017 ”Për miratimin e rregullores për procedurat e miratimit dhe mbikëqyrjes së organeve evropiane të notifikuara dhe organeve të miratuara të vlerësimit të konformitetit”, Kreu VII, pika c).

Shënim për operatorët ekonomikë:

Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera

shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike¹. Këto dokumente duhet të *paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin*.

- Autoriteti/enti kontraktor përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, do t'i kërkojë ofertuesit fitues nëpërmjet Sistemit të Prokurimit Elektronik që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet e bëra në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas Shtojcës 9 të DST. Mosparaqitja e dokumentacionit përmbushës për këto pika do të jetë kusht skualifikimi.
- Autoriteti Kontraktor mund të beje verifikimin e dokumentacionit në përputhje me vetëdeklarimin e bërë gjatë fazes së ofertimit. Konstatimi i mospërputhjeve midis Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit dhe dokumentacionit të dorëzuar përben kusht skualifikimi.
- Në çdo rast AK ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik ose t'i kërkojë operatorit ekonomik sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

“Inspektim periodik i ashensorëve të QSUT, Marrëveshje Kuadër me afat 12 muaj”

Nr.	Vendinstalimi i ashensorit/ Godina	Nr. Serial
1	Spitali A2	HAS 20/0965
2	Spitali A2	HAS 0021/0437
3	Spitali A2	HAS 0021/0439
4	Spitali A2	HAS 0021/0368
5	Spitali A2	HAS 0021/0436
6	Spitali A2	HAS 0021/0367
7	Spitali A2	HAS 0021/0438
8	Spitali A2	HAS 0021/0351
9	Spitali A2	HAS 20/0964

10	Spitali A2	HAS 0021/0362
11	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23885
12	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23886
13	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23887
14	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23898
15	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23896
16	Spitali i Ri (A1)	SDOPPLER 23897
17	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23892
18	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 23982
19	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 24797
20	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 24798
21	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 24809
22	Spitali i Ri (A1)	DOPPLER 24810
23	Spitali Nr.1 (6-kateshi)	DOPPLER 1867
24	Spitali Nr.1 (6-kateshi)	DOPPLER 1868
25	Spitali Francez	KLEEMANN 52515
26	Spitali Francez	KLEEMANN 52516
27	Depo Farmaceutike	GERMANI NR.03
28	Depo Farmaceutike	GERMANI NR.04
29	Depo Farmaceutike	GERMANI NR.05
30	Djegje-Plastika	FASAL 2437
31	Onkologjiku	DORNER 787
32	Qendra e Konsultave	FASAL 02
33	Infektiv	AH&MET 2203313
34	Infektiv	AH&MET 2203314
35	Pediatri e Re (Urgjenca)	KONE 44129174
36	Pediatri e Re (Urgjenca)	KONE 44129175
37	Pediatri e Re (Urgjenca)	KONE 44129176
38	Pediatri e Re (Urgjenca)	KONE 44129177
39	Pediatri e Re (Urgjenca)	KONE 44129180
40	Pediatri e Re (Urgjenca)	KONE 44129181
41	Pediatria e Specialiteteve	DOPPLER 2201
42	Pediatria e Specialiteteve	DOPPLER 2202
43	Pediatria e Specialiteteve	KONE 44129172
44	Pediatria e Specialiteteve	KONE 44129173
45	Pediatria e Specialiteteve	KONE 44129178
46	Pediatria e Specialiteteve	KONE 44129179
47	Neurokirurgjia	GERMANI 06

48	Neurokirurgjia	DOPPLER 2804
49	Neurologjia	DOPPLER 2481
50	Neurologjia	DOPPLER 2482

Argumentimi: Specifikimet teknike janë vendosur në bazë të relacionit me nr. 1132/6 prot., datë 26.05.2025 Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt **“Inspektim periodik i ashensorëve të QSUNT. Marrëveshje Kuadër për 12 muaj”**, bazuar në urdhër të titullarit të përgjithshëm me Nr. 186 datë 05.05.2025”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 1132/17 prot., datë 01.08.2025 ‘Kërkesë për rihapje procedure’ të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse si dhe në përputhje me nenin 4 pika 38/b, nenin 36 të Ligjit nr. 162/2020, “Për Prokurimin Publik”, nenin 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

Shtojca 7

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimet që kërkohen që kërkohen: **Inspektim periodik i ashensorëve të QSUT, Marrëveshje Kuadër me afat 12 muaj, për 50 (pesëdhjetë) ashensorë ekzistues të QSUT, të cilët kanë të dhëna teknike të ndryshme (markë, vit prodhimi, vit instalimi, ngarkesë të lejuar, shpejtësi të lejuar, etj, të ndryshme) dhe mirëmbahen nga një operator ekonomik kompetent i kontraktuar nga AK, për riparim-mirëmbajtjen e ashensorëve të QSUT**

Afatet e ekzekutimit:

- 1. Inspektimi i parë do të kryhet menjëherë pas lidhjes së kontratës**, për të 50 ashensorët ekzistues në përdorim të QSUT, sipas një grafiku të përcaktuar nga përfaqësues të Sektorit Teknik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse QSUT dhe dakordësuar.
- 2. Inspektimi i dytë do të kryhet në varësi të përmbushjes së periudhës 6-mujore nga inspektimi i fundit** për secilin ashensor, sipas një grafiku të përcaktuar nga AK dhe

dakortësuar. Data e lëshimit të çertifikatës do të konsiderohet si data e vlefshme për llogaritjen e periudhës së ardhshme të inspektimit

Përshkrimi i shërbimit	Nr.ashensorëve për inspektim (copë)	Numri i inspektimeve (copë)	Njësia	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Inspektim Periodik i Ashensorëve (përfshirë ri-inspektimin)	50	100	copë	PAI-et e QSUNT	12 muaj

Shtojca 8

(Shtojcë për t’u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCES

A. Kriteret Tekniko-ligjore për Operatorin Ekonomik ofertues:

- Operatori Ekonomik ofertues duhet të jetë i pajisur me **Akt Vendimin e Miratimit “Organ i Miratuar” i vlerësimit të konformitetit**, të lëshuar nga **Ministria e Financës dhe Ekonomisë**, ku:
 - Fusha e veprimtarisë në Aktin e Miratimit të përkohë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen, pra me “Inspektimin periodik të ashensorëve”;
 - Periudha e vlefshmërisë së vendimit të jetë e vlefshme dhe të përfshijë periudhën e prokurimit dhe të shtrirjes së kësaj Marrëveshje Kuadër.
- Organi i Miratuar dhe personeli i tyre duhet të jetë i aftë të kryejë veprimtarinë e inspektimit periodik të ashensorëve sipas detyrave që i janë caktuar nga pjesa përkatëse e legjislacionit dhe për të cilën ai është miratuar: **Ligji Nr.10489/ 2011** i ndryshuar; **VKM 1056/2015** e ndryshuar, **VKM 192 / 2018**.

3. Organi i Miratuar duhet të ketë politikat dhe procedurat e duhura për kryerjen e veprimtarisë së Inspektimit Periodik, të cilat marrin parasysh madhësinë e ndërmarrjes, sektorin në të cilin ajo funksionon, natyrën, strukturën e tij, shkallën e kompleksitetit të teknologjisë së produktit në fjalë dhe masën/sasinë.
4. Organi i vlerësimit të konformitetit duhet të ketë mjetet e nevojshme për kryerjen e detyrave administrative dhe teknike të lidhura me veprimtarinë e Inspektimit Periodik në mënyrën e përshtatshme dhe të ketë mundësi të përdorë të gjitha pajisjet e nevojshme.
5. OM duhet të jetë në gjendje të mbulojë gjithë territorin e njësive spitalore, sipas kërkesës së AK.
6. OM duhet të ketë në dispozicion personel me: aftësi të larta teknike; trajnim profesional; njohuri të kënaqshme të kërkesave të vlerësimeve të cilat ata kryejnë dhe kompetencën e përshtatshme për kryerjen e këtyre vlerësimeve; të dispozitave përkatëse të legjislacionit përkatës për produktet; aftësi të hartimit të çertifikatave, të regjistrave dhe të raporteve që demonstrojnë kryerjen e vlerësimit të konformitetit.
7. Gjatë veprimtarisë së tyre organi i vlerësimit të konformitetit, drejtuesit më të lartë administrativë dhe teknikë dhe personeli i vlerësimit të konformitetit duhet të garantojnë paanshmëri.
8. Personeli i organit të vlerësimit të konformitetit duhet të ruajë sekretin profesional për të gjithë informacionin e marrë gjatë kryerjes së detyrave të tij nën legjislacionin përkatës, që ndikon ndaj subjektit të vlerësuar, me përjashtim të autoriteteve kompetente shtetërore.

B. Grafiku i Inspektimit dhe Ri-inspektimi në rast Moskalimi/ Afatet për Ekzekutimin e Shërbimit dhe Likudimi i Faturës

1. Objekti i procedurës

Objekti i kësaj procedure është realizimi i inspektimit teknik periodik për 50 (pesëdhjetë) ashensorë, të instaluar në godina spitalore të ndryshme, brënda territorit të QSUT, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi të sipërcituar.

2. Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e kësaj marrëveshje do të jetë për një periudhë 12-mujore. Gjatë kësaj periudhe është parashikuar që secili ashensor të inspektohet 2 herë (çdo 6

muaj nga inspektimi i mëparshëm, sipas afateve kohore ligjore).

3. Grafiku i Inspektimeve dhe Kërkesat e Përgjithshme.

a) Inspektimi periodik do të kryhet për **50** (pesëdhjetë) **ashensorë ekzistues** të QSUT, të cilët kanë të dhëna teknike të ndryshme (markë, vit prodhimi, vit instalimi, ngarkesë të lejuar, shpejtësi të lejuar., etj, të ndryshme) dhe mirëmbahen nga një operator ekonomik kompetent i kontraktuar nga AK, për riparim-mirëmbajtjen e ashensorëve të QSUT.

b) Inspektimi periodik do të kryhet si më poshtë:

- **Inspektimi i parë do të kryhet menjëherë pas lidhjes së kontratës**, për të 50 ashensorët ekzistues në përdorim të QSUT, sipas një grafiku të përcaktuar nga përfaqësues të Sektorit Teknik, në Drejtorinë e Shërbimeve Mbështetëse QSUT dhe dakordësuar.

- **Inspektimi i dytë do të kryhet në varësi të përmbushjes së periudhës 6-mujore nga inspektimi i fundit** për secilin ashensor, sipas një grafiku të përcaktuar nga AK dhe dakortësuar. Data e lëshimit të certifikatës do të konsiderohet si data e vlefshme për llogaritjen e periudhës së ardhshme të inspektimit.

c) Përfaqësuesit e Organit të Miratuar do të kontaktojnë me përfaqësuesit e AK, Sektorin Teknik/DSHM, për organizimin e çdo inspektimi apo ri-inspektimi. Sektori Teknik i DSHM do t'i sigurojë organit të miratuar të gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm, si dhe do t'i krijojë/lehtësojë kushtet për kryerjen e inspektimit, duke i shoqëruar gjatë gjithë procesit të inspektimit.

ç) Organi i Miratuar i kontraktuar nga QSUT, angazhohet të realizojë inspektimin e ashensorëve të përcaktuar sipas grafikut të AK dhe dakortësuar, **brenda 30 ditëve** nga njoftimi i autoritetit kontraktor.

d) Organi i Miratuar, për çdo ashensor që ka kryer inspektimin periodik, harton me shkrim raportin mbi inspektimin i cili përmban informacionin e specifikuar sipas Pikës 14 të **VKM nr.1056/ 2015**, “Për miratimin e rregullit Teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”.

dh) Çdo ashensor i cili kalon sukseshëm inspektimin e periudhës së parë 6-mujore, pajiset me Certifikatën e Inspektimit dhe do të planifikohet për inspektimin e periudhës së dytë, brënda kushteve të kësaj marrëveshjeje. Data e lëshimit të certifikatës do të konsiderohet si data e vlefshme për llogaritjen e periudhës së ardhshme të inspektimit.

4. Moskalimi i Inspektimit dhe Ri-inspektimi

a) Në rast se, gjatë inspektimit teknik periodik konstatohet se një ashensor për shkak të një risku nuk plotëson kushtet tekniko-ligjore të sigurisë dhe nuk mund të certifikohet, Pala Ekzekutuese, pra OM, do të hartojë një raport teknik të detajuar që dokumenton të gjitha

mangësitë e evidentuara, si dhe afatin kohor brënda të cilit duhet të realizohen riparimet/modifikimet e kërkuara. (Neni 7.8 i **VKM nr.1056/ 2015**, “Për miratimin e rregullit Teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”).

- b) **Afati kohor i lënë për ri-inspektimin e detyrave të lëna do të dakortësohet paraprakisht me AK**, duke marrë parasysh jo vetëm shkallën e kompleksitetit të riparimit në varësi të defektit që paraqitet; por edhe sektorin në të cilin AK operon, rëndësinë, madhësinë, fluksin e punës dhe numrin e madh të ashensorëve në përdorim.

Theksojmë se QSU “Nënë Tereza” është institucioni shëndetësor më i madh në Shqipëri dhe si institucion shëndetësor akademik është i vetmi i këtij lloji, duke u klasifikuar si e vetmja qendër shëndetësore terciare shqiptare.

(Kërkesa është mbështetur në **Nenin 19, pika 11 “Kërkesat për organet e miratuara”**, të **Ligjit Nr.10489** prot., datë 15.12.2011 “Për tregtimin dhe mbikëqyrjen e tregut të produkteve joushqimore”, i ndryshuar).

- c) Në përfundim të riparimeve të kryera nga një organizëm kompetent për mirëmbajtje, në rastin konkret nga operatori ekonomik i kontraktuar nga AK për riparim-mirëmbajtjen e ashensorëve; AK do të njoftojë me shkrim OM, i cili duhet të kontrollojë nëse këto riparime janë kryer korrektësisht dhe ashensori mund të vazhdojë përdorimin e tij të sigurt. Në këtë rast OM, pas përfundimit të rivlerësimit të detyrave të lëna, bashkëlidh ri-inspektimin në Raportin Përfundimtar të ashensorit dhe lëshon Çertifikatën e Inspektimit, nëse vlerësohet përmbushja e kriterëve teknike të përcaktuara në legjislacionin në fuqi. (Kërkesa është mbështetur në Nenin 7.8 dhe 7.9 të **VKM nr.1056/2015**, “Për miratimin e rregullit Teknik “Për sigurinë e ashensorëve në përdorim”);
- d) Organi i Miratuar angazhohet të realizojë ri-inspektimin brënda 15 ditëve nga njoftimi i autoritetit kontraktor, **pa asnjë kosto shtesë për AK**.

5. **Faturimi dhe likuidimi**

Faturimi dhe likuidimi do të kryhet në varësi të numrit të ashensorëve të inspektuar/ri-inspektuar plotësisht nga OM, si më poshtë:

- Ashensorët të cilët **kalojnë me sukses inspektimin periodik të radhës**, do të likujdohen nga AK, sipas tarifës së dakortësuar në këtë MK, pas lëshimit të Çertifikatës së Inspektimit dhe raportit përkatës me informacionin e specifikuar nga OM.

- Ashensorët të cilët **për shkak të një risku nuk plotësojnë kushtet tekniko-ligjore të sigurisë** dhe OM në Raportet e Inspektimit **ka lënë detyra dhe dakortësuar afate** për përfundimin e punimeve, për sjelljen në konformitet të ashensorit; **do të faturohen dhe likujdohen**, sipas tarifës së dakortësuar në këtë Marrëveshje Kuadër, **pas ri-inspektimit të detyrave të lëna nga OM në Raportet e Inspektimit** dhe lëshimit të Çertifikatës së Inspektimit dhe/ose Raportit Përfundimtar të ashensorit me vlerësimin përkatës.

Argumentimi: Sasia dhe Grafiku i levrimit janë vendosur në bazë të shkresës nr. 1132/6 prot., datë 26.05.2025 Relacion për llogaritjen e fondit limit, hartimin e specifikimeve teknike dhe argumentimin e nevojave për procedurën e prokurimit me objekt **“Inspektim periodik i ashensorëve të QSUNT. Marrëveshje Kuadër për 12 muaj”**, bazuar në urdhër të titullarit të përgjithshëm me Nr. 186 datë 05.05.2025”, nga Komisioni i argumentimit, bashkelidhur kërkesës nr. 1132/17 prot., datë 01.08.2025 ‘Kërkesë për hapje procedure’ të Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse, si dhe në përputhje me piken 3, germa c të nenit 15 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar.

NJËSIA E PROKURIMIT: